



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 156

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 10 shtator 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 9.9.2024	Për lirimimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit..... 18991
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 207/10, datë 6.9.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiptonja– Lumi i Tiranës, loti I dhe QMT” 18991
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nr. 62-2024-3252 (360), datë 18.6.2024	Për shpalljen e zhdukur të shtetasit Osman Nexhi..... 18993
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nr. 499 (1841), datë 18.7.2024	Për heqjen e plotë të zotësisë për të vepruar të shtetasit Përparim Krahi..... 18993
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nr. 290 (1049), datë 23.4.2024	Për heqjen e plotë të zotësisë për të vepruar të shtetasës Ëngjëllushe Olldashi..... 18993



VENDIM
Nr. 553, datë 9.9.2024

**PËR LIRIMIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË
SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 6, shkronja “c”, e 8, të nenit 56, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Muhamet Rrumbullaku, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË
Nr. 207/10, datë 6.9.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja–Lumi i Tiranës, loti I dhe QMT’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **605,648.60** (gjashtëqind e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë pikë gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT															
“PLOTËSIMI, RAKORDIMI DHE VAZHDIMI I PUNIMEVE ‘SHESHI SHQIPONJA’-LUMI I TIRANËS, LOTI I DHE QMT”															
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë				Tokë “truall”			Objekt “banimi”			Vlera totale (lekë)	Shënime
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m²	Lloji i pasurisë								
								Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi m²	Vlera lekë		
1	Alida“Kontakt” sh.p.k.	Haki	Maçi	8310	12/309	536.00	Truall	19.4	31,219.00	605,648.60			0.00	605,648.60	Seksioni E: Me VKM-në nr. 463, datë 10.6.2020, pezullohen transaksionet deri në hedhjen e gjurmës në hartën kadastrale dhe kalimin e pronësisë në favor të shtetit, sipas VKM-së nr. 463, datë 10.6.2020, pasuria nr. 12/139, ZK 8310 është shpronësuar për sip. 862.6 m², nga 882 m² në total. Sipas shkresës së ASHK-së nr. 2886/2 prot., datë 7.5.2024, për këtë pasuri rezultojnë të pa shpronësuar 19.4 m² truall në pronësi të Alida Haki Maçi dhe “Kontakt” sh.p.k.
2	Shtet			8310	12/282	178.00	Truall	70.2		0.00			0.00	0.00	Seksioni E: Kjo pasuri është okupuar nga Haxhi Balla , Shaqir Shutina, Emilian Muco, Andrea Gaqo Furxhi, Micello Bacu, Vasil Shallo. Seksioni D: Haxhi Balla , Shaqir Shutina, Emilian Muco, Andrea Gaqo Furxhi, Micello Bacu, Vasil Shallo janë bashkëpronarë të pasurive me nr. 12/132-nd., vol. 14, f. 122; 12/133-nd., vol. 14, f. 123; 12/134-nd. Vol. 14, f. 124 12/135-nd., vol. 14, f. 125, që ndodhet mbi truallin 12/282, vol. 104, f. 15.
Totali								89.6		605,648.60	0.00		0.00	605,648.60	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me vendimin nr. 62-2024-3252 (360), datë 18.6.2024, vendosi shpalljen e zhdukur më datë 16.2.1994 të shtetasit Osman Nexhi, me atësi Ibrahim dhe me amësi Hatixhe, i datëlindjes 18.5.1969, lindur në Kukës dhe me vendbanim të fundit në Plug, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, si dhe caktimin e shtetasit Ardjus Nexhi si kujdestar për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në emër të shtetasit Osman Nexhi.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. 499 (1841), datë 18.7.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Përparim Krasi, i datëlindjes 16.10.1960, për shkak të papërgjegjshmërisë së plotë mendore, si dhe caktimin si kujdestar vëllain e tij, shtetasin Shefqet Krasi.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. 290 (1049), datë 23.4.2024, vendosi heqjen e plotë të zotësisë juridike për të vepruar të shtetases Ëngjëllushe Olldashi, e datëlindjes 1.12.1949, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të shtetasit Jani Olldashi.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 32 lekë